

1. Si e vlerësoni skepticizmin aktual në BE për zgjerimin dhe a do të thotë kjo se vendet e Ballkanit Perëndimor nuk do të bëhen pjesë e BE-së së shpejti?

Skepticizmi për zgjerimin në BE nuk është diçka e re. Ka kohë tashmë që ekziston një lloj lodhjeje nga zgjerimi. Qytetarët e BE-së duken të kujdesshëm tani për anëtarët e rinj, ndoshta për shkak të frikës së dobësimit të Bashkimit. Megjithatë, unë besoj se kjo është një frikë e pabazë dhe rrjedhojë e paragjykimëve dhe e keqinformimeve të hershme apo qoftë edhe për shkak të mungesës së plotë të informacionit. Do të duhet shumë ndërgjegjësim si nga vetë shtetet anëtare të BE-së, ashtu edhe nga vetë ne në rajon për t'i bindur skeptikët për të kundërtën: për t'u treguar atyre se ne e meritojmë këtë titull duke i bërë ato çka themi.

Nga ana tjetër, kemi tashmë një Komision të ri Evropian të sapoformuar, i cili ka një agjendë shumë kërkuese për rigjallërimin e Bashkimit Evropian. Presidentja, znj. van der Lejen, ishte shumë e qartë kur tha se Ballkani Perëndimor i përket Evropës, pasi jemi pjesë e të njëjtit kontinent dhe ndajmë të njëjtën kulturë, histori dhe fat, dhe se dera e Bashkimit Evropian është e hapur për rajonin.

Dhe nuk duhet të fiksoheni me datat. Anëtarësimi në BE është shumë më shumë se aq. Bëhet fjalë për procesin e mbërritjes atje, për të treguar më të mirën tonë në këtë proces. Edhe nëse do të na ofrohej të bëheshim pjesë e Bashkimit Evropian që nesër, ne nuk jemi gati. P.sh., tendenca e rritjes ekonomike të Ballkanit Perëndimor ishte 3.5% në vitin 2019 me një parashikim rritjeje prej 3.8% në vitin 2020, e megjithatë PBB-ja për frymë është ende më e ulët se sa një e treta e shtetit anëtar më të pasur të BE-së, Gjermanisë. Dhe ky është thjesht një shembull. Na pret shumë punë përpara. Punë që duhet bërë dhe që duhet bërë më shpejt sesa deri tani.

2. A prisni që të pranohet propozimi i Francës dhe që të ndryshojnë kriteret e anëtarësimit në BE? Çfarë do të thoshte kjo në veçanti për Malin e Zi, i cili ka ecur më shumë në negociatat e anëtarësimit?

Dokumenti francez që ndryshe njihet me emrin “*non-paper*”¹, duket se ka tërhequr shumë vëmendje dhe ka shumë gjasa që të shndërrohet në bazën e kriterëve të reja dhe të përditësuar të pranimit. Këtë do ta shohim së shpejti. Megjithatë, deri atëherë, pavarësisht emrit që do të ketë, unë personalisht (dhe besoj se edhe partnerët tanë në rajon do të ishin dakord me mua) pres të

¹ Material me anwn e tw cilit kontribuohet nw mwnyrw teknike nw lidhje me njw çwshtje tw caktuar, duke i hedhur ato pika pwr diskutim nga institucionet e BE-sw ose nga Shtetet Anwtare.

shoh një model të qartë dhe të saktë për atë çka pritet prej të dyja palëve, duke vendosur themelet e një procesi të drejtë dhe të parashikueshëm, tek i cili mund të mbështeteshin të gjitha palët. Ka ardhur koha t'u japim fund shtirjeve dhe t'u qëndrojmë premtimeve dhe angazhimeve tona. Mosmarrja e një vendimi për hapjen e bisedimeve me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë tregojnë mungesë qartësie të procesit ekzistues.

Dhe nuk kam ndërmend të rrezikoj e të hamendësoj se çfarë do të ndodhë me hapjen e bisedimeve me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut apo se çfarë do të thotë ky model për të gjithë ne, duke përfshirë këtu edhe Malin e Zi. Megjithatë më lejoni të them se shpresoj që në marrjen e të gjitha vendimeve të mbizotërojë kthjelltësia. Plotësimi i Evropës me Ballkanin Perëndimor është detyrë dhe jo nder!

3. Së fundmi, Ambasadori francez në Maqedoninë e Veriut tha se progresi i arritur nga Mali i Zi është vetëm në letër dhe se në thelb janë vetëm 10-12 familje që po bëhen më të pasurat në vend dhe se për këtë arsye, rregullat e anëtarësimit duhet të rishikohen. Çfarë mendoni për progresin e Malit të Zi? A mund të kishin qenë më të mira rezultatet?

Besoj se nuk duhet të komentojmë për këtë.

4. Çfarë e ngadalëson më shumë rrugën e Ballkanit Perëndimor drejt BE-së? Cilat janë problemet që nuk po zgjidhin vendet e Ballkanit Perëndimor?

Nuk është se ka diçka të veçantë që e ngadalëson progresin e rajonit në rrugën drejt BE-së, por do të thosha që rajoni ia del, sa herë që ekziston një vullnet i fortë politik dhe vendosmëri për të sjellë ndryshime. Pikërisht kjo është ajo që na duhet më shumë.

Siç thashë, anëtarësimi në BE është një proces, jo një datë, dhe ndryshimet nevojiten jo thjesht për hir të përmbushjes së kërkesave të BE-së, por për ne që jetojmë këtu, si dhe për ata që po largohen prej këtu.

Ne jemi një treg i vogël – gjithsej rreth 18 milionë vetë – dhe të mësosh se 61% e të rinjve (dhe tani po flas për të ardhmen) e mbështesin integrimin në BE, por është e qartë se nuk janë gati të presin që të ndodhin këto ndryshime në shoqëritë e tyre, pasi po 61% e tyre janë gati të lënë shtëpitë dhe të shkojnë jashtë shtetit në kërkim të një jete më të mirë. Adresimi i kësaj çështjeje është prioritet dhe për ta bërë këtë, duhet të punojmë së bashku, të lëmë pas të kaluarën, zhgënjimet, hidhërimin, mosmarrëveshjet dhe

keqardhjet dhe të hapim një faqe të re – për rininë që po vjen. Krijimi i kushteve për ta që të studiojnë, të gjejnë punë, të udhëtojnë, të zbulojnë, të sistemohen, të ngrenë familje ... t'i bëjmë të ndihen se mund të mbështeten tek ne.

5. Çfarë prisni nga Presidenca kroate e Këshillit të BE-së? A do t'i ndihmojë ajo vendet e Ballkanit Perëndimor?

Unë pres shumë nga Presidenca e ardhshme kroate e Këshillit të BE-së në vitin 2020, si edhe nga rajoni. Kroacia është shteti më i ri anëtar i BE-së dhe i vetmi në rajon që është anëtarësuar në BE që prej samitit të Selanikut në vitin 2003, ku Këshilli Evropian deklaroi se “e ardhmja e Ballkanit është brenda BE-së”. Mendoj se ata i kuptojnë rrethanat dhe do të jenë në anën tonë. Megjithatë, nuk mund të presim që të jetë Kroacia, Franca apo Gjermania që të zgjidhin çështjet tona, të realizojnë reformat e nevojshme apo të transformojnë shoqëritë tona. Kjo është diçka që duhet ta bëjmë vetë – të përveshim mëngët e t'i hyjmë punës.

6. Ka pasur një nismë për krijimin e tregut të përbashkët të Ballkanit Perëndimor, e cila ka dështuar. Tani kemi një nismë të re: mini-Shengeni? A prisni që kjo nismë të jetojë?

Nëse i referoheni Zonës Ekonomike Rajonale – ajo nismë nuk ka dështuar. Është ende në skenë, ndonëse afatet për arritjen e rezultateve janë zgjatur. E megjithatë, arritja kryesore është Marrëveshja Rajonale për Shërbimin *Roaming*, nënshkruar në prill, sipas së cilës çmimet e shërbimit “roaming” kanë rënë në mënyrë drastike që prej kësaj vere dhe duke filluar nga viti 2021, Ballkani Perëndimor nuk do të ketë më tarifa për “roaming” mes shteteve të veta, ndërkohë që ne do të punojmë për uljen e kostove të “roaming-ut” mes rajonit dhe BE-së. Kemi gjithashtu edhe Agjendën Rajonale për Reformën e Investimeve (RIRA), si dhe plane për promovimin e rajonit si një destinacion tërheqës për investitorët. Ka edhe plane për të mundësuar njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale dhe akademike në të gjithë rajonin. Megjithatë, ky plan, për të cilin kanë rënë dakord liderët e Ballkanit Perëndimor në vitin 2017, është ende në fazën, kur kërkon një pamje të re. RCC-ja, së bashku me partnerët tanë në rajon dhe me BE-në, po punon për versionin e përditësuar, për të përfshirë në të edhe dimensionin social, gratë, rininë, dimensionin për aftësimin për tregjet aktuale të punës, kalimin nga punësimi informal në atë formal, sigurinë, etj. për të reflektuar realitetet e sotme, pasi gjërat kanë ndryshuar që prej vitit 2017. Dhe kjo është diçka që BE-ja e mbështet fuqimisht.

RCC-ja është plotësisht e angazhuar për bashkëpunimin rajonal. 74% e qytetarëve në rajon besojnë në të. Megjithatë, bashkëpunimi rajonal është një proces në zhvillim. Kështu që, nisma e Ohrit, e Novi Sadit apo e mini-Shengenit – sido që ta quani, si nismë me synim heqjen e barrierave në rajon, duhet të merren në konsideratë. Megjithatë, bashkëpunimi rajonal ka kuptim vetëm nëse destinacioni përfundimtar është integrimi në BE, pjesë e të cilit duhet të jenë që të gjashta këto ekonomi. A do të jetojnë këto nisma? Të presim e të shohim.

6. Mali i Zi nuk e ka pranuar këtë nismë. A mendoni se ky vendim është i mirë? Çfarë humbet Mali i Zi nëse e refuzon këtë nismë?

Presidenti Gjukanovic mori pjesë në takimin e zhvilluar në Tiranë, në dhjetor, vitin e kaluar, për nismën e lëvizjes së lirë, ku u shpreh qartë se Mali i Zi është shumë i angazhuar për bashkëpunim rajonal, duke shtuar se do të ishte kënaqësi të vazhdonte të merrte pjesë në këto bisedime brenda kuadrit të kësaj nisme në të ardhmen dhe për të kontribuar në rajonin e Ballkanit Perëndimor për arritjen e integritit të plotë evropian sa më shpejt që të jetë e mundur.

Dhe e fundit: bashkëpunimi rajonal është gjithmonë i dobishëm dhe, me një vullnet të fortë politik, edhe efektiv. Qytetarët tanë e dinë këtë – 74% e mbështesin bashkëpunimin rajonal dhe besojnë se ai mund t'u përmirësojë jetën. Komisioni Evropian e di këtë gjë po ashtu, pasi ky është një prej parakushteve për rrugëtimin e anëtarësimit të rajonit në BE. Liderët në rajon e dinë. Prandaj edhe të gjitha përpjekjet në këtë aspekt mund të jenë veçse një hap përpara, por edhe një shenjë e pranimit të liderëve rajonalë të autorësisë së angazhimeve dhe të kredibilitetit të tyre.

7. A është mini-Shengeni thjesht një zëvendësim i anëtarësimit në BE, për të cilin do të duhet të presim gjatë?

Anëtarësimi në BE nuk mund të zëvendësohet me asgjë, prandaj unë e shoh këtë nismë si një hap përpara drejt bashkimit të forcave dhe heqjes së barrierave ekzistuese për tregtinë, lëvizjen e njerëzve, mallrave, etj. dhe si i tillë duhet të shihet ky proces.

Bashkëpunimi rajonal në përgjithësi nuk është zëvendësim i integritit në BE. Ai është një model i funksionimit të Bashkimit Evropian. Duke qenë se integrimi në BE është synimi i përbashkët i të gjitha ekonomive në rajon, pse të mos merret seriozisht përfundimisht duke përfituar nga avantazhet që ai ofron.

